



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2264/ 2 prot.,

Datë 19.09.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “2Z Konstruksion” SHPK & “ASI-2A CO” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF- REF-77189-08-10-2023, me objekt “Rehabilitimi i ambienteve tek kompleksi “Fushat sportive Pishinat” me fond limit: 28,023,943 (njëzetë e tetë milion e njëzetë e tre mijë e nëntëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “2Z Konstruksion” SHPK & “ASI-2A CO” SHPK me NIPT J63229466K, me adresa: rruga “Strum – Sukë, Lagjia “Zoga”, Km. 3, Roskovecë, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Sportive Tirana.
Adresa: Rruga “Kristo Luarasi”, Tiranë.

Në datën 18.09.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. 2264 protokolli, datë 18.09.2023 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “2Z Konstruksion” SHPK & “ASI-2A CO” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF- REF-77189-08-10-2023, me objekt “Rehabilitimi i ambienteve tek kompleksi “Fushat sportive Pishinat” me fond limit: 28,023,943 (njëzetë e tetë milion e njëzetë e tre mijë e nëntëqind e dyzetë e tre) Lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 28.08.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Sportive Tirana.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “2Z Konstruktion” SHPK & “ASI-2A CO” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që bashkimi i operatorëve ekonomikë “2Z Konstruktion” SHPK & “ASI-2A CO” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2264 prot., datë 18.09.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

Komisioni i vlerësimit të ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit për përmbushjen e kriterëve për kualifikim, të përcaktuar në dokumentet e tenderit konstaton se:

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve 2Z Konstruktion sh.p.k & ASI -2A shpk skualifikohet, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të saktë për të deshmuar plotësimin e të gjitha kriterëve të kërkuara në DST, konkretisht nuk ka plotësuar kriteret sipas:

O.E. 2Z Konstruktion sh.p.k nuk ka paraqitur Shtojcën 4. Lista e Informacionit Konfidencial sipas kërkesës së kërkuar në DST.

O.E. ASI -2A shpk nuk ka paraqitur Shtojcën 4. Lista e Informacionit Konfidencial sipas kërkesës së kërkuar në DST.

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Bashkimi i O.E. nuk ka paraqitur O.E. 2Z Konstruktion sh.p.k në vertetimin e kontributeve të dorezuara nuk ka përfshirë në punonjësve për periudhën Korrik 2023 sipas kërkesës së DST, gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues për drejtuesit Teknik të kërkuar, ku përfshihen “Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv”.

O.E. gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues për punonjës të specializuar/të kualifikuar të kërkuar, ku përfshihen

- *kontratën individuale të punës;*

- *një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional /certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara*

nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

O.E. ASI -2A sh.p.k nuk ka paraqitur vertetimin e kontributeve sipas kërkeses se DST, gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per drejtuesit Teknik te kerkuar, ku perfshihen “Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv”.

O.E. gjithashtu nuk ka paraqitur dhe dokumentacionin shoqerues per punonjës të specializuar/të kualifikuar te kerkuar, ku perfshihen

- *kontratën individuale të punës;*
- *një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional /certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.*

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Bashkimi i O.E. nuk ka paraqitur dokumentacionin për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 19.09.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri